

NJOFTIM PËR KONSULTIM ME PUBLIKUN

Titulli : Konsultim publik për miratimin e shpalljes së zonave prioritare të zhvillimit në territorin e bashkisë Durrës.

Propozuesi i projektaktit: Kryetari i Bashkisë.

Qëllimi: Konsultim publik me banorët dhe grupet e synuara të interesit dhe ato të marginalizuara të Bashkisë Durrës ka për qëllim mbledhjen e sugjerimeve të komunitetit lidhur me ndryshimet apo propozimet për ndryshime për miratimin e shpalljes së zonave prioritare të zhvillimit në territorin e bashkisë Durrës.

Kalendari i konsultimit: Konsultimi me komunitetin do të zhvillohet **në Njësitë Administrative si më poshtë:**

- Ishëm, në datën 15 Dhjetor 2025, ora 10.00, lokal Isa Sura, qendër Ishëm
- Manëz, në datën 15 Dhjetor 2025, ora 12.00, lokal Sami Hoxha
- Rrashbull, në datën 16 Dhjetor 2025, ora 10.00, Kompleksi “Migrimi”

Sugjerimet janë të mirëpritura **deri më datë 16 Dhjetor 2025**, në adresat e emailit:

info@durres.gov.al

keshillidurres@gmail.com

Pjesëmarrës:

- Këshilli Bashkiak dhe Administrata e Bashkisë Durrës.
- **Nga komuniteti:** Banorët e Bashkisë Durrës, anëtarët e shoqërisë civile, anëtarë të biznesit, medias, përfaqësues të komuniteteve fetare në Durrës, grupe të ndryshme interesi apo grupet e marginalizuara, etj.

Forma e konsultimit: Në terren

Qëllimi i këshillimit publik	Konsultimi publik synon përfshirjen e mendimeve, sugjerimeve dhe rekomandimeve të komunitetit lidhur me për miratimin e shpalljes së zonave prioritare të zhvillimit në territorin e bashkisë Durrës. Ky proces është një mundësi e rëndësishme për qytetarët dhe grupet e interesit për të shprehur pikëpamjet e tyre dhe për të kontribuar në zonat për zhvillim brenda territorit të Bashkisë Durrës në përputhje 20/2025 "Për paketën e maleve"; Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar si dhe në bazë të Udhëzimit nr.2, datë 15.10.2025 "Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për dokumentacionin dhe procedurën e shpalljes së zonës prioritare të zhvillimit në territoret e Bashkive" dhe të evidentoj zonat me prioritet sipas "Shprehjeve të Interesit" të paraqitura online në sistemin e ngritur për këtë qëllim.
	Në territorin e Bashkisë Durrës deri më tani kanë shprehur interes 107 aplikantë në platformën digjitale e-albania me sipërfaqe të përgjithshme

Përshkrimi i çështjes.	rreth 238.825 ha, aplikues për tu shpallur posedues jopronar, në kategori të ndryshme përdorimi si: pyll, kullotë, djerr, tokë bujqësore e pandare etj. Aplikimet janë të përqëndruar më së shumti në Njësitë Administrative Ishëm, Manëz dhe Rrashbull. Shprehjet e interesit janë të pozicionuara në njësitë strukturore N-natyrë dhe B-bujqësore si agroturizëm, pentari, ferma, bujtina etj. Për të gjitha kërkesat grupi i punës do të verifikojë situatën faktike në terren me administratorin e njësisë administrative përkatëse dhe bashkëpunojë me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, gjithashtu këto prona nuk duhet të janë pjesë e zonave të mbrojtura me ligj të posaçëm.
Kontaktet dhe afatet e dërgimit të komenteve, rekomandimeve, vërejtjeve;	Komentet dhe rekomandimet tuaja jepen në adresat e emailit të bashkisë dhe sekretariatit të Këshillit Bashkiak, BRENDA DATËS 16 Dhjetor 2025. Info@durres.gov.al keshillidurres@gmail.com
Ndryshimet kryesore dhe/ose alternativat e mundshme	Opsionet e mundshme janë për t'u shqyrtuar nga ana e Këshillit : Shqyrtimin e aplikimeve dhe sugjerimeve të ardhura nga komunitetit në Njësitë Administrative me synimin përmirësimin e zonave prioritare të zhvillimit në territorin e bashkisë Durrës.
Projekt-vendimi, relacioni shoqërues, në lidhje me çështjen që konsultohet.	Materialet dhe relacionet për konsultimin me publikun mund t'i gjeni në faqen Web të bashkisë, faqja kryesore. https://durres.gov.al/category/bashkia/njoftime/ https://durres.gov.al/konsultimet-publike/
Shpjegim të procesit që do ndjekë dhe veprimet që do të ndërmarë Këshilli për të shqyrtuar rekomandimet nga publiku deri në marrjen e vendimit	Pas mbledhjes së rekomandimeve, Këshilli i Bashkisë do të ndjekë hapat si vijon: 1. Realizimin nga ana e Sekretariatit të Këshillit i një Përmbledhje të Rekomandimeve dhe rezultateve të plota që përfshin të gjitha mendimet dhe propozimet që do të vijnë nga komuniteti dhe bërja publike e kësaj Përmbledhje; 2. Dërgimi i kësaj Përmbledhje Rekomandimesh Kryetarit të Bashkisë, Komisionit të Zhvillimit Urban dhe Përdorimit të Tokës, Komisionit të Pronave Publike, Transportit dhe Trafikut Rrugor, Komisioni i Politikave të Zhvillimit të Turizmit si dhe çdo këshilltari të bashkisë; 3. Shqyrtimi nga ana e komisioneve të mësipërme të çdo rekomandimi dhe të opinionit të Kryetarit të Bashkisë; 4. Marrja e vendimit për rekomandimet që do të përfshihen në paketën e maleve.

	5. Diskutimi dhe miratimi i aktit në seancën e hapur të Mbledhjes së Këshillit; 6. Publikimi i aktit në faqen e Këshillit të Bashkisë dhe në tabelat e informimit; 7. Njoftimi i administratës për aktin e miratuar; 8. Monitorimi i zbatimit të tij.
Data e publikimit	05.12.2025